



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-25450, dt. 29 Maj 2025.

Në bazë të nenit 12, pika 12.1 dhe pika 12.2 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 4 paragrafi 1.2. së Rregullores të MAPL-së nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, dispozitave të nenit 20 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Nr.01-016/01-413431/2020 dt.30 shtator 2020, Kuvendi i Komunës së Pejës, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.05.2025, pas zhvillimit të procedurave të diskutimit publik, miratoi këtë:

RREGULLORE

Nr. 02/2025 (KPE)

Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02-2023 (KPE) për Taksa Komunale

Neni 1.

Të hiqet neni 14 me të gjithë paragrafët e tij, ku shkruan, citim:

Neni 14

Tarifat për shërbimet profesionale në zgjedhjen dhe damkimin e trungjeve dhe lëshimin e lejeve për prerje në pyjet publike dhe private

1. Për zgjedhjen, damkimin, dhe lëshimin e lejeve për prerjen e trungjeve të klasifikuar si asortiment teknik (industrial) dhe për trungjet e klasifikuar si dru për djegie, do të zbatohen tarifat si vijonë:

- | | |
|--|-----------------------------|
| 1.1. për zgjedhjen dhe damkimin e trungjeve të klasifikuar si dru teknik | 3,00 €/m³ |
| 1.2. për zgjedhjen dhe damkimin e trungjeve të klasifikuar si dru zjarri, me vëllim më të vogël se 7 m ³ (me qëllim të përdorimit për nevoja shtëpiake) | 1,50 €/m³ |
| 1.3. për zgjedhjen dhe damkimin e trungjeve të klasifikuar si dru zjarri, me vëllim më të madh se 7 m ³ | 2,00 €/m³ |

Të zëvendësohet me një nen tjetër të ri, citim:

Neni 14

Dhënia me qira e tokës bujqësore – pronë komunale për m², për kultivimin e kulturave njëvjeçare, sipas tipit të tokës.

Klasa e I deri IV 0.07 €/m²
Klasa e V deri VIII 0.05 €/m²

Neni 2

Të gjitha nenet tjera nga rregullorja bazike mbesin në fuqi.

Neni 3

Kjo Rregullore shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Ëeb-faqen e Komunës së Pejës.

Ti dërgohet:

MAPL,
Kryetarit të Komunës,
Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi (DBPH),
Arkivë.

